



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria Komunale e Arsimit

Nr. 07-340/03-0064816/24

Datë: 27.09.2024

Në bazë të nenit 23 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, neni 11 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore, Komuna e Mitrovicës së Jugut, shpall:

## KONKURS

(për përzgjedhjen e agjencisë së udhëtimit të nxënësve për ekskursion jashtë vendit - Shqipëri)

### I. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim të agjencioneve turistike:

- Formulari i aplikimit (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Licenca e Agjencionit turistikë;
- Çertifikata e agjencionit transportues;
- Dëshmia e kontrollimit teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore rrugore;
- Agjencioni duhet të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollave;
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasëve të autobusëve;
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (çertifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Autobusët duhet të jenë komfor dhe me klimë;
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;

### II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së agjencioneve turistike:

Përzgjedhja e agjencioneve turistike do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2016, dhe sipas kërkesave të shkollave.

### III. Shkollat të cilat kanë bërë kërkesë për ekskursion janë:

- SHML Gjimnazi "Frang Bardhi" numri i nxënësve dhe mësimdhënësve afërsisht (300-330),
- SHMLM "Dr.Xheladin Deda" numri i nxënësve dhe mësimdhënësve afërsisht (300-330),
- SHMLE "Hasan Prishtina" numri i nxënësve dhe mësimdhënësve afërsisht (170-200)
- SHMLT "Arkitekt Sinani" numri i nxënësve dhe mësimdhënësve afërsisht (140-170)



Vendi: Shqipëri

Koha: Gjatë muajit tetor, sipas agjendave të Institucionve Shkollore

#### **IV. Afati dhe mënyra e aplikimit**

**Konkursi mbetet i hapur 7 ditë nga data e publikimit të konkursit më 27.09.2024 deri më datën 03.10.2024 që konsiderohet si dita e fundit dhe mbyllja e konkursit;**

Dokumentet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga Komisioni.

Konkursi publikohet edhe në ueb-faqe zyrtare të Komunës: <https://kk.rks-gov.net/mitroviccejugut/>



Drejtorja e Arsimit

Drejtoresha Drita Kadriu

